

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

AKT THEMELIMI

I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "FITO 2022" Shpk

Në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Ligjit Nr.9273 datë 03.07.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar :

Sot, më datë 04.03.2022 ne themeluesit kemi krijuar, Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "FITO 2022" Shpk, me Ortakë, shtetasit:

1. Z. Indrit Hamiti i datëlindjes 19.06.1975, lindur në Durrës dhe banues në Lagjia Nr. 4, Rruga "Egnatia" , Pallati Nr. 1120, Durrës, shtetas shqiptar i identifikuar me Pasaportën me numër BD6893833 dhe me numër personal, H50619135I; 2. Z. Petrit Avdyli i datëlindjes 04.07.1964, lindur në Durrës, banues në Lagjia Nr. 18, Rruga "Kristo Sotiri" , Pallati Nr. 521, Durrës, shtetas shqiptar i identifikuar me Letërnjoftim (ID) me numër 036456105 dhe me numër personal, G40704049N

Shoqëri e cila do të funksionojë në bazë të këtij, AKT-THEMELIMI.

LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË

NENI 1

Lloji i Shoqërisë Tregtare është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj është "FITO 2022" Shpk. Emri tregtar i kësaj Shoqërie është Financing, Investment, Trade, Opportunity.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 2

Zyra Qëndrore e Shoqërisë Tregtare "FITO 2022" Shpk, e ka vendodhjen e saj në, Lagjia Nr. 11, Rruga "Dëshmorët", Zona Kadastrale 8514, Numër Pasurie 1/26-N4, Sip. 24,5 M², Durrës.

REGJIMI JURIDIK

NENI 3

Shoqëria është shqiptare me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria FITO 2022n personalitetin juridik në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 4

Objekt i Shoqërisë Tregtare "FITO 2022" Shpk është :

Veprimtari në fushën e, këmbimit valuator, exchange, transferta të parasë brenda dhe jashtë vendit për të tretët në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo bankë, agjent për shërbimin e pagesave për të tretët në emër dhe për llogari të një subjekti financiar jo bankë, veprimtari në fushën e financimit, investimit dhe oportuniteteve financiare. Agjent Komisioner. Broker. Investitor strategjik.

KOHËZGJATJA

NENI 5

Shoqëria Tregtare "FITO 2022" Shpk, do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhe kohore të papërcaktuar.
Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQËRISË

NENI 6

Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërisë Tregtare "FITO 2022" Shpk, përbëhet prej 100,000.00 (njëqindmijë) lekë.
Pjesmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e:

1. Z. Indrit Hamiti: Zotëruese 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 51.000.00 (pesëdhjetë e një mijë) lekë.
2. Z. Petrit Avdyli: Zotërues 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën 49% të kapitalit themeltar të shoqërisë e barabartë me 49,000.00 (dyzet e nëntë mijë) lekë.

ADMINISTRIMI

NENI 7

Administrator i Shoqërisë i emëruar është Z. Petrit Avdyli me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

TË DREJTAT E SHOQËRISË

NENI 8

Shoqëria ka të drejtë të lidh kontrata dhe të nënshkruaj marrëveshje Brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur. Shoqëria përballon humbjet vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributit të Kapitalit Themeltar.

VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 9

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

SHPËRNDARJA E FITIMIT

NENI 10

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën sipas ligjit dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme. Ky fitim shpërndahet midis Ortakëve të Shoqërisë sipas kontributit të kuotave në kapitalin themeltar të shoqërisë.

LIKUJDIMI

NENI 11

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likujdatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emërtesën shtesë "shoqëri në likujdim e sipër". Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortakët.

Aktin e themelimit e lexuam dhe e gjetëm konform vullnetit tonë dhe e nënshkruajmë pa verejtje.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "FITO 2022" Shpk

Indrit Hamiti

Indrit Hamiti



Petrit Avdyli

PETRIT AVDYLI

